



Rrjeti NATURA 2000 dhe roli i shoqerise civile ne te

Nje nga detyrimet baze te procesit te afrimit te vendit tone me standartet e kerkuara Europiane per mjedisin dhe mbrojtjen e natyres e biodiversiteti eshte dhe krijimi i rrjetit te Natura 2000. Ai eshte nje sistem qe me pak fjale ka te beje me vendosjen e nje rrjeti te zonave me interes per ruajtjen e habitateve dhe specieve (ne vendin tone me thjesht quhen zonat e mbrojtura). Sot ai mbulon rreth 20% territorit ne Europe dhe afron nje instrument legal per ruajtjen dhe mbrojtjen e habitateve e llojeve me vlere. Mund te konsiderohet si sistemi me i avancuar dhe efektive per mbrojtjen e natyres dhe si i tille eshte nje prej arritjeve me te medha te politikave mjedisore te BE-se. Ai perfshin dy direktivat kryesore, Direktiven e Habitave dhe ate te Shpendeve qe kane te bejne me mbrojtjen e natyres, flores dhe faunes dhe krijimin e rrjetit europian te zonave te mbrojtura (Rrjeti Natura 2000). Vendosja e ketij rrjeti eshte pjese edhe e detyrimeve te Konventes se Kombeve te Bashkuara per Diversitetin Biologjik (UNCBD) dhe Strategjise Pan-Europiane per Diversitetin Biologjik dhe ate Pejshazor (PEBLDS).

Nga pikpamja teknike e shkencore ku rrjet do te thote nje analize e detajuar e te gjithë habitateve dhe ekosistemeve qe formojne territore te caktuara dhe specieve kryesore qe gjenden ne kete zone. Kjo eshte nje pune teper voluminoze dha ka nje forme e metodologji teper te percaktuar per tu studiuar e paraqitur. Institucionet shtetore qe lidhen me mjedisin kane detyrimin te percaktojne politika te qarta ne mbeshtetje te ketij procesi si edhe te lehtesojne punen qe behet nga aktore te ndryshem ne drejtim te vendosjes se rrjetit Natura 2000. Nga ana tjeter po njihet gjithmone e me shume roli i shoqerise civile ne kete proces si nje element teper i nevojshem per informimin e te gjithë aktoreve dhe krijimin e rrjeteve institucionale mbeshtetes ne kete proces qe lehtesojne menyren e te kuptuarit te ketij sistemi.

Duhet te pranojme qe ne Shqiperi ende nuk ka nje kuptim te drejte te politikave mjedisore dhe atyre mbrojtese, si nga autoritetet shtetore ashtu edhe nga organizatat jo fitimprures qe perfaqesojne grupe te ndryshem aktoresh. Kjo situatë shume here pengon zbatimin e politikave efektive mjedisore dhe per ruajtjen e natyres, qe shpesh nxjerr ne pah konflikte te panevojshme dhe keqkuptime midis grupeve te interesit.

Mund te themi se tashme ka ardhur koha qe ne vendin tone, politika per shtimin e siperfaqeve te zonave te mbrojtura te drejtohet me shume ne kahun e miremnaxhimit te tyre dhe ngritjes se nje rrjeti me standarte europiane, qe eshte ai i Natura 2000. Per kete duhet nja partneritet i ekuilibruar dhe teper bashkepunues midis institucioneve shtetore dhe organizatave te shoqerise civile, per te arritur qellimin e percaktuar nga politika shqiptare e te gjitha kraheve, futja sa me shpejt ne familjen europiane.

Ne kete kontekst se fundmi ka filluar nga puna projekti me titull “Mbrojtja e biodiversitetit – fuqizimi i rolit te OJF-ve per promovimin e rrjetit Natura 2000”, i paraqitur nga zyra e organizates nderkombetare WWF per Mesdheun te (WWF MedPO) ne partneritet me shoqaten shqiptare Instituti per Ruajtjen e Natyres ne Shqiperi (INCA) dhe i mbeshtetur nga fondet KE-se ne kuader te programit CARDS, nepermjet zyres se Delegacionit European ne Tirane. Projekti ka si objektiv



kryesor nxitjen e rolit dhe ngritjen e nje rrjeti per organizatat te shoqerise civile ne te gjithë vendin per vendosjen e rrjetit Natura 2000. Projekti qe perben nje perpjekje modeste per te iniciuar kete levizje, por qe ka qellime afatgjata, do te zgjase 18 muaj duke filluar nga Tetori 2009 dhe ka nje buxhet prej rreth 94.000 Euro.

Projekti do te synoje kryesisht qe te rrise kapacitetet e OJF-ve dhe disa institucioneve lokale qe ne te ardhemen e afert do te perfshihen ne kete çeshtje. Aktivitete kryesore ne kete projekt qe do te zgjase deri ne Mars 2011 do te jene:

1. Krijimi i nje grupi pune per Natura 2000 (N2000_WG) me pjesmarrjen e OJF-ve me aktive ne fushen e mbrojtjes se natyres e zonave te mbrojtura,
2. Nenshkrimi i nje Memorandumi Mirekuptimi midis OJF-ve qe do te perkrasin kete inisitive duke ngritur nje rrjet per kete ceshtje dhe nje tjetër me Ministrine e Mjedisit,
3. Organizimi i dy trainimeve tre ditore me perfaqesues te OJF-ve dhe institucioneve lokale (nje ne Shkoder nje ne Korçe) me tematika per Natura 2000, Vleresimin Strategjik Mjedisor dhe Ndikimin ne Mjedis, mbeshtetjen e organizatave jo qeveritare, etj;
4. Kryerja e nje vizite ne nje prej projekteve te ngjashem ne rajon (Kroaci, Serbi ose Bosnje);
5. Pergatitja dhe organizimi i nje workshopi kombetare rreth problematikes se Natura 2000;
6. Pergatitja e nje studimi “Udhezues per Natura 2000 ne Shqiperi”.

Per te prezantuar kete projekt ne daten 22 Janar ne ambjentet e hotel Mondial, u mbajt mbledhja inaguruese e ketij projektit. Ne mbledhje moren pjese perfaqesues te shoqatave te ndryshme, specialiste te zonave te mbrojtura, perfaqesues te institucioneve shkencore qe lidhen me kete problem etj. Merrnin pjese edhe perfaqesuesit e zyres se Delegacionit European, perfaqesuesit e zyres se WWF MedPO, si edhe Shefi i Sektorit te Zonave te Mbrojtura dhe Parqet Kombetare, dhe Shefi i Sektorit te Faunes, Flores dhe Tokes te Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Admistrimit te Ujerve. Ne takim ku u prezantuan objektivat dhe aktivitetet e projektit, pjesmarrësit u shprehen te gatshem per te dhene ndihmesen e tyre ne ecurine e tij. Ne pergjithesi debatet e zhvilluara ishin pozitive duke mbeshtetur aktivitetet e projektit dhe te gjitha propozimet e bera. Nenshkrimi i nje memorandumi bashkeponimi ndermjet perfaqesuesve te OJF-ve qe do te marrin pjese ne grupin e punes u perkrah dhe gjithashtu u kerkua nga perfaqesuesit e INCAs qe te vazhdojne procedurat per hartimin e draftit te marreveshjes me Ministrine e Mjedisit. Gjithashtu u percaktuan zona e Korçes dhe Shkodres si dy vendet e pershtatshme per zhvillimin e workshopeve trajnues me qellim perfshirjes sa me te madhe te shoqerise civile ne te tere vendin. Ne fund, perfaqesuesit e WWF MedPO deklaruan vullnetin e kesaj organizate qe te vazhdojne punen per hartimin e nje aplikimi ne kauder te programeve Europiane (IPA) ne lidhje me vendosjen e rrjetit Natura 2000 ne Shqiperi si nje prej detyrimeve qe rrjedhin me hyrjen e Shqperise ne Bashkimin European, qe do te bej te mundur fillimin e nje pune me konkrete per vendosjen e ketij rrjeti ne Shqiperi.

Se fundmi Instituti i Ruajtjes se Natyres ne Shqiperi mirepret çdo organizate jo fitimpruese qe deshiron te marre pjese ne kete rrjet te ri te shoqerise civile i cili do te loze rol aktiv ne te ardhmen per ngritjen e sistemit Natura 2000 ne vendin tone. Per me shume informacion se shpejto do te keni nje faqe te veçante ne faqen e internetit www.inca-al.org

Zamir DEDEJ